



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 1237 prot.

Vlorë, më 23.08 2025

Kalendari i konsultimit publik

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.151 datë 11.03.2025

Sqarime për projektaktin: Relacioni sqarues i projektaktit përcakton arsyet e paraqitura nga propozuesi i projektaktit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë :

- Miratimi i draftit të projektbuxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi draftin e buxhetit afatmesëm 2026-2028.

Grupet që do të konsultohen:

Banorët e qytetit të Vlorës, të njësive administrative Orikum, Qendër, Novoselë dhe Shushicë, Shoqata e biznesit me perfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, OJF dhe Media, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë etj.

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Rajoni 1	11.08.2025	Bar Halloween	17.00	Takim publik	Bisedë
2	Rajoni 2	12.08.2025	Pallati i Kulturës	17.00	Takim publik	Bisedë
3	Rajoni 3	13.08.2025	Pallati i Kulturës	17.00	Takim publik	Bisedë
4	Rajoni 4	14.08.2025	Bar Relax	17.00	Takim publik	Bisedë
5	Rajoni 5	15.08.2025	Bar 8 Nëntori	17.00	Takim publik	Bisedë

6	Njësia Administrative Orikum	11.08.2025	Në ambjentet e NjA	10.00	Takim publik	Bisedë
7	Njësia Administrative Shushicë	12.08.2025	Në ambjentet e NjA	10.00	Takim publik	Bisedë
8	Njësia Administrative Novoselë	13.08.2025	Në ambjentet e NjA	10.00	Takim publik	Bisedë
9	Njësia Administrative Qendër	14.08.2025	Në ambjentet e NjA	10.00	Takim publik	Bisedë
10	Shoqata e biznesit me perfaqësues.	15.08.2025	Pallati i Kulturës	10.00	Takim publik	Bisedë

KRYETAR

Ermal Dredha

